REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 828/20
Datë/Datum. 05.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit 31/10/2020*	*Data e dorëzimit të raportit 05/11/2020*
Dior Halili		

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 15.10.2020, **OE "Limit Project SH.P.K & Delta-CCD SH.P.K" – Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **828/20** kundër njoftimit për anulim të aktivitetitetit të prokurimit, me numër **"634-20-2704-5-2-1"**, respektivisht atij me titull "NDERTIM I KANALEVE TE UJITJES LOT 1- NE DOLLOVE, LOT 2- NE STUP", iniciuar nga AK – Kuvendi Komunal i Klinës.

Me datën: 29.10.2020, **OE "NNT Shkodrani" – Klinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **863/20** kundër njoftimit për anulim të aktivitetitetit të prokurimit, me numër **"634-20-2704-5-2-1"**, respektivisht atij me titull "NDERTIM I KANALEVE TE UJITJES LOT 1- NE DOLLOVE, LOT 2- NE STUP", iniciuar nga AK – Kuvendi Komunal i Klinës.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 80,000.00€. Ndarja në lotë: po (2).

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim.

10.06.2020 – Njoftimi për kontratë
23.06.2020 (ora 1300) – Afati i fundit për pranimin e tenderëve
06.07.2020 – Kerkese per sqarim – 1
17.07.2020 – Kerkese per sqarim - 2
24.07.2020 13:28 – VENDIM PER ANULIM - KANALET E UJITJES L1- DOLLOV DHE LT 2 - STUP.pdf
24.07.2020 - Kerkese per rishqyrtim nga LIMIT PROJECT SH.P.K.
03.08.2020 9:42 – Njoftim mbi refuzimin e kerkeses per rishqyrtim
03.08.2020 – Parashtrimi i ankesës nga Limit Project në OSHP
04.09.2020 – Vendimi OSHP
15.10.2020 10:14 VENDIM MBI REZULTATIN E PROKURIMIT KANALET E UJITJES 15.10.2020.pdf

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-

068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

Si sqarim, për faktin që ky raport përfshin pretendimet ankimore të 2 operatorëve ekonomik ankues të të njëjtit aktivitet të prokurimit, pretendimet ankimore do të listohen me radhë duke filluar nga ato të OE ankues "OE "Limit Project SH.P.K & Delta-CCD SH.P.K" – Prishtinë", pastaj "OE "NNT Shkodrani" – Klinë". Konstatimi i fakteve (pjesa 3) dhe përgjigjet ndaj pretendimeve (pjesa 7) përmban të njëjtën renditje.

Me datën: 15.10.2020, **OE "Limit Project SH.P.K & Delta-CCD SH.P.K" – Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **828/20** kundër njoftimit për anulim të aktivitetitetit të prokurimit, me numër **"634-20-2704-5-2-1"**, respektivisht atij me titull "NDERTIM I KANALEVE TE UJITJES LOT 1- NE DOLLOVE, LOT 2- NE STUP", iniciuar nga AK – Kuvendi Komunal i Klinës.

OE ankues ka pretenduar që janë shkelur këto dispozita ligjore:

- **Neni 1 – Qëllimi**
- **Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**
- **Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi**
- **Neni 28 – SPECIFIKIMET TEKNIKE**
- **Neni 59 – EKZAMINIMI, VLERËSIMI DHE KRAHASIMI I TENDERËVE**
- **Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës**
- **Neni 69 – Aftësia teknike dhe / ose PROFESIONALE**
- **Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë – paragrafet 1, 2 dhe 3.**

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për prokurimin publik (RRUOPP) – pika 39 – sqarimi i tenderëve

Tek NENI 1 – Qëllimi, Autoriteti kontraktues ka shkelur këtë NEN për shkak se qëllimi duhet të realizohet dhe se buxheti i alokuar nga AK nuk është tejkaluar.

Tek NENI 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti – AK duke caktuar vetë buxhetin e vlerësuar njëherë, deklarohet se mund të dëmtohet buxheti, ndërkohë që çmimi jonë i ofruar është më poshtë se buxheti.

Tek NENI 7 – Barazia në Trajtim / jo-diskriminimi, AK na ka diskriminuar në vlerësim, duke qenë se jemi ofertues të përgjegjshëm dhe se jemi brenda buxhetit të alokuar si dhe kemi dhënë dy herë plotësim – sqarim pas kërkesës se AK, edhepse dokumentacionin e kërkuar nga AK e kemi dorëzuar me dosjen e tenderit në afatin e paraparë. Ne kemi dorëzuar pranimin teknik - dhe sipas dosjes së tenderit është kërkuar PRANIMI TEKNIK ose REFERENCA, ndërkohë që AK ka dalë jashtë kërkesave në FDT dhe ka kërkuar edhe REFERENCËN, të cilën e kemi dërguar me kohë. Pastaj AK ka kërkuar dokumentacion shtesë edhe për paisjet si TRAKTORI 4X4, të cilin dokumentacion e kemi dorëzuar me kohë në dosjen e tenderit. Këtu kemi filluar të dyshojmë se AK është tendencioze në vlerësim, dhe kjo u konfirmua, me rastin e vendimit për anulim të këtij tenderi, duke u thirrë në buxhet, edhepse ne kemi qenë me ofertën tonë brenda buxhetit të planifikuar nga AK, pastaj AK nuk ka arritur të formojë komisionin. Kjo forcon bindjen se AK ka preferenca për ndonjë kompani të caktuar dhe paraqet vepër penale. Prandaj, për të na eliminuar këtë dyshim, ftojmë drejtorin e Prokurimit të AK – Kuvendi Komunal Klinë – z. Abaz Foniqi, që t'i vlerësojë këto shqetësime dhe kërkesën tonë për RISHQYRTIM. Sepse, dikush duhet të japë përgjegjësi për këto veprime skandaloze të pabazuara në asnjë NEN të LPP dhe rregulloreve të KRPP.

Tek NENI 28 – Specifikimet teknike.

NENI 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, AK, duke mos gjetur ndonjë mangësi në dokumentacionin e prezentuar nga ana jonë, ka vlerësuar pa kurrfarë kriteri duke shkelur të gjitha dispozitat ligjore në këtë NEN dhe merr vendimin arbitrar (në fakt skandaloz) për anulimin e këtij procesi. AK, duhet të bëjë vlerësimin e tenderëve pasiqë vetë e ka shpallur tenderin.

Tek NENI 60 – Kriteret për dhënien e kontratës – AK ka shkelur këtë kriter duke anashkaluar dhe duke mos vlerësuar se ne si kompani kemi plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana juaj.

Tek NENI 69 – Aftesia teknike dhe / ose profesionale, ne si kompani kemi plotësuar të gjitha kërkesat TEKNIKE dhe Profesionale, të cilat i keni caktuar vetë ju si AUTORITET KONTRAKTUES.

Tek NENI 72 – Dokumentacion dhe informacioni shtesë – paragrafet 1, 2 dhe 3 – ne si OE kemi plotësuar të gjithë dokumentacionin shtesë të kërkuar nga ana juaj, dhe ju arbitrarisht, merrni vendim për anulim, dhe kjo ngjallë dyshime për vepër penale.

Tek RRUOPP – AK ka pranuar të gjithë dokumentacionin sipas RRUOPP.

Duke qenë se ne si kompani kemi ofertuar në këtë tender me kriteret e caktuara nga AK, ne kemi plotësuar dokumentacionin brenda afatit të caktuar, dhe si duket AK ka pasur preferenca tjera, edhepse ne jemi kompani që kemi plotësuar kriteret e caktuara nga AK. Problemi më i madh se AK ka parashtruar dy arsye për anulim. Njëra arsye me rastin e anulimit të tenderit, ku AK është thirrur në NENIN 1 të LPP dhe supozon në dëmtimin e buxhetit, ndërsa pas kërkesës sonë për ri-shqyrtim, AK ka nxjerrë arsye se kriteret janë diskriminuese, thuajse kompanitë kanë caktuar kriteret dhe jo AK.

Prandaj, OSHP të anulojë vendimin e AK dhe të shpallë fitues për të dy Lotet kompaninë LIMIT PROJECT SHPK dhe DELTA-CCD SHPK.

Me datën: 29.10.2020, **OE "NNT Shkodrani" – Klinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **863/20** kundër njoftimit për anulim të aktivitetitetit të prokurimit, me numër **"634-20-2704-5-2-1"**, respektivisht atij me titull "NDERTIM I KANALEVE TE UJITJES LOT 1- NE DOLLOVE, LOT 2- NE STUP", iniciuar nga AK – Kuvendi Komunal i Klinës.

OE ankues ka pretenduar që janë shkelur këto dispozita ligjore:

AK gjatë zhvillimit të ketij aktivitei te prokurimit konkretisht gjatë procesit të vlersimit të tenderëve ka bere shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.04/L-042 per Prokurim Publik të Republikes se Kosovës, i ndryshuar dhe plotesuar me ligjin Nr.04/"-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092.

- **AK ka shkelur nenin 1,6, 7, 59, 60, dhe 62 pika 1 dhe 1.1 dhe pika 2.1 e ketij neni të LPP të amandamentuar.**

Pretendimi 1.

- Autoriteti Kontraktues me rastin e te berit te pasukseseshme te ofertes sone dhe anulimit te ketij aktiviteti te prokurimit ka **shkelur nenin 1,6, 7, 59, 60, dhe 62 pika 1 dhe 1.1 dhe pika 2.1 e ketij neni të LPP të amandamentuar.**

Anulimi i ketij AP nga ana e AK KOMUNA E KLINËS është i padrejt dhe i paarsyeshem per arsye se çmimi i ofertes tonë është çmimim qe nuk e tejkalon vleren e parashikuar per realizim te kontrates dhe ne si OE i kemi plotesuar te gjitha kerkesat e dosjes se tenderit ashtu siq jane kerkuar.

AK Komuna e Klinës gjate vlersimit te ofertave e ka shkelur nenin 59 te LPP-se sepse nuk ka bere vlersim real te ofertave dhe nenin 62 pika 1 dhe 1.1 dhe pika 2.1 e ketij neni të LPP të amandamentuar te LPP-se sepse nuk ka baze per anulim te akivitetit te prokurimit (AP).

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë ne si OE kerkojm :
nga PANELI SHQYRTUES i OSHP-së QË ANKESEN TONË TA E PRANOJ SI TË BAZUAR DHE KËTË PROCEDUR TA E KTHEJ NË RIVLERSIM në menyrë që AK KOMUNA E KLINËS të ketë mundesi të i eleminoj shkeljet e bera dhe ne te shpallemi fitues të ketij aktiviteti të prokurimit.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Fakt 1: Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar:

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1.Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatëperiudhes se fundit prej 36 muajeve para dates se njoftimit per kontrate ka qenë prej jo më pak se LOT 1= 140.000.00 Euro, LOT 2= 20.000,00 EURO D	**1. Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur.Ne vlerat dhe afatin e kerkuar.**

Fakt 2: Kapaciteti Teknik dhe Profesional:

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te natyres se ngjashme, ne vlere minimale prej Lot 1=112.500.00, oo Euro,, Lot 2= 15.000.00 euro në periudhen e fundit prej 36 muajeve vitet e fundit para dates se publikimit te Njoftimit për kontratë),. Nese jane ne grup operatoresh . 1. OE duhet te plotesoj dhe dorezoj një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten certifikatat për kryerje te punëve- apo referencat pozitive .	**1. OE duhet te plotesoj dhe dorezoj një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten certifikatat për kryerje te punëve- apo referencat pozitive .**
2.Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme - Udhëheqës i punishtes - Inxhinier i dip. i hidros ,apo ndertimtarise – min. 3 vite përvojë pune pas diplomimit. Udhëheqësi i punishtes duhet te ketë udhëhequr se paku 2 (dy) kontrate - Nje Inxhinier ose baçelor te ndërtimtarisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit. -Operatori ekonomike duhet te ofroj dëshmi për min. 10 punëtor ne stafin e tij, ne profesionet qe lidhen me natyren e puneve , .	**2- Udhëheqës i punishtes - CV-a, Kopja e Diplomes, Kontrata e punës me punëdhënësin Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit për udhëheqësin e punishtes. • nje Inxhinier ose baçelor te ndërtimtarisë - CV, Kopja e Diplomes, kontrata e punës •Kopjet e certifikatave, CV, kontrata e punës Stafi mbeshtes Me kontrta te rregullta pune apo parakontrat . Regjistri i tyre , kualifikimet .**
3.Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit. Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT. Mjete obligative . 1. Eksavator per hapje te kanaleve kapaiceti 25- 32 T … cope 1. 4. Traktor me luge perpara 4x4 me rimorkio .. cope 1 5. Dhe vegla tjera pune per kete aktivitet .	**3. OE duhet te plotesoj dhe dorezoj listen e pasijeve duke plotësuar Aneksin 7 te Dosjes se Tenderit dhe duhet te baskangjes Deklaratat unike doganore ose kontrata ose fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka mareveshje per shfrytezimin, OE duhet te dorezoj edhe marreveshjen per shfrytezim.**

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
N/A

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT 531, 532, 545/20
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY 04.09.2020

PSH.nr.531/20
532/20
545/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik: "Elezaj" SH.P.K- Klinë, OE "Limit Project" SH.P.K &" DELTA –CCD" SH.P.K- Prishtine dhe OE NNT "Shkodrani" – Klinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Ndërtimi i kanaleve të ujitjes, Lot 1- Në Dollovë, Lot 2- Në Stup" me nr. të prokurimit: 634-20-2704-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues "Kuvendi Komunal Klinë", më datën 03.09.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHEN**, si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik: "Elezaj" SH.P.K- Klinë, OE "Limit Project" SH.P.K &" DELTA –CCD" SH.P.K- Prishtine dhe OE NNT "Shkodrani" – Klinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Ndërtimi i kanaleve të ujitjes, Lot 1- Në Dollovë, Lot 2- Në Stup" me nr. të prokurimit: 634-20-2704-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues "Kuvendi Komunal Klinë".

II. **ANULOHET**, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: "Ndërtimi i kanaleve të ujitjes, Lot 1- Në Dollovë, Lot 2- Në Stup" me nr. të prokurimit: 634-20-2704-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues "Kuvendi Komunal Klinë", dhe lënda të kthehet në **rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues jep këtë mendim si në vijim:

Paraprakisht, duhet thënë që për këtë aktivitet të prokurimit është hera e dytë që po shqyrtohen ankesat rreth njoftimit për anulim të aktivitetit. Numri referues i ankesave, gjegjësisht vendimit të lëshuar nga paneli për ankesat paraprake është: 531-532-545/20.

Për të konstatuar pretendimet e lartpërmendura nga të dy OE ankues, Eksperti vlerëson që duhet rekapituluar ngjarja në mënyrë kronologjike si më poshtë:

- **4 shtator** – vendimi i OSHP-së mbi anulimin për vendimin për anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës, respektivisht rivlerësimin e lëndës.
- **22 shtator** – Abaz Foniqi (Menaxher i Prokurimit) dërgon email duke potencuar:

From: Abaz Foniqi
Sent: Tuesday, September 22, 2020 10:00 AM
To: Zenun Elezaj
Cc: Naser A. Morina
Subject: VLERESIMI I TENDERIT KANALET E UJITJES NE BOKSHIQ DHE STUP

PERSHNEDETJE

PERKUNDER VENDIMIT PER RI VLERESIM TE PROCEDURES PAS VENDIMIT TE OSHP , ENDE KOMISIONI NUK KA PERFUNDUAR OBLIGIMIN E TYRE .

JU LUTEM TE NA INFORMONI ME PROCESIN MEQ BAZUAR NE VENDIMIN E OSHP- VLERESIMI DUHET PERFUNDUAR BRENDA 10 DITESH .

NISUR NGA KJO NGA NJE SHKELJE PO KALOJM NE SHKELJE TJERA TE LPP.

ME RESPEKT

- **5 tetor** – Abaz Foniqi (Menaxher i Prokurimit) dërgon email duke potencuar rëndësinë e perfundimit të punës/vlerësimit të komisionit vlerësues

From: Abaz Foniqi
Sent: Monday, October 05, 2020 12:43 PM
To: Zenun Elezaj; Naser A. Morina
Cc: Ajet Sejdiu
Subject: FW: VLERESIMI I TENDERIT KANALET E UJITJES NE BOKSHIQ DHE STUP

Pershendetje

Ju perkujtoj perkunder kerkeses se pare dhe Obligimit qe Komisioni eshte dashur te sjell nje rezultat te Ri Vlersimit Te ofertave ai nuk eshte perfunduar .
Fjala eshte pas Vendimit te OSHP qe lend ate Ri-Vleresohet .

Ju lutem te merrni hapat e nevojeshem bazuar ne Nenit 59 te LPP -detyra dhe Obligimet e Komisionit te Vlersimit te tendereve .
Detyrat dhe Obligimet e ZKA dhe Zyrtarit Autorizuaes ..

Ju perkujtoj se Zyra e prokurimit Kerkon perfundim te Punes se Komisionit ne te kunderten pasojat per humbje te projektit jane zingjirore nga Komisioni per mos pefundim te punes se ture , Njesia Kerkuse dhe ZKA .

Me respect

- **12 tetor** – Abaz Foniqi (Menaxheri i Prokurimit) dërgon email tek ZKA dhe Komisionit të vlerësimit:

PER: - ZLA – Kryetarit z. Zenun Elezaj

01-352-23371/20

KOPJE - Zyrtarit Autorizues – Drejtori z. Naser Morina
- Komisionit te Ri-Vleresimit : Ajet Sejdiu , Luan Qerkinaj dhe Shendrit Gashi

NGA: Abaz Foniqi -Zyra e Prokurimit , Komuna Kline

DATE: 12.10.2020

SUBJEKTI: RI – VLERESIMI I TENDERIT NR. 634-20-2704-521 NDËRTIMI I KANALEVE TE UJITJES LOT 1- DOLLOVE DHE LOT 2- STUP

Me date 04.09.2020 OSHP ka sjell Vendimin e Panelit per Ri_vleresim te kësaj procedure , dhe Konform LPP , Neni 59 te LPP 04/L-042 I NDRYSHUAR DHE AMANDAMENTUAR ne LPP 04/L-237 , ate nr.05/L-68 DHE NR.05/-092, ESHTE Caktuar Komisioni per Ri –Vleresim te cilet me date 09.09.2020 kane marr Dosjen per te kryer Ri_vleresimin sipas Vendimit te OSHP nr.,531-532-545/20 i dates 04.09.2020, Ku kjo ende eshte kthyer ne Ri-Vleresim , dhe Konform nenit 59 te vazhdohet me tej.

Per kunder kërkesave qe ju keni drejtuar Komisionit , Juve te nderuar Kryetar dhe Drejtorit te Njesise kërkuese (date 22.09.2020 dhe 05.10.2020) , ende Nuk kam ndonje përgjigje , e as Lenda nuk eshte kthyer ne Zyre te Prokurimit .

Nisur nga Kjo Neni 59 i LPP ka afatet qe Procesi i Vleresmit duhet te përfundoj brenda 30 ditesh pas Hapjes se Ofertave (ne ratin konkret) Vendimi te OSHP per kthimin e lendes ne Ri-Vleresim .

Ju përkujtoj se tanime eshte shkelur Ky nen dhe Pasojat duhet adresuar tek MOS PERFUNDIMI i punes se Komisionit te Vleresimit per mos kryerje te punes sipas Vendimit .

Lendes i bashkangjes :

Vendimin e OSHP
Shkresat drejtuar Komisionit te Rivleresimit , ZKA dhe Zyrtarit Autorizues .

- **14 tetor** – Abaz Foniqi (Menaxher i Prokurimit) pranon shkresën dorëzuar nga anëtarët e komisionit vlerësues ***1) Luan Qerkinaj*** dhe ***2) Shendrit Gashi***, ku në shkresë thuhet që pa praninë e kryetarit të komisionit vlerësues, anëtarët e lartpërmendur nuk kanë pasur kompetenca që të shpallin fituesin.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPSTINA KLINA

www.komuna-kline.org

Për: z.Abaz Foniqin, Menaxher i Prokurimit, Klinë

Për: z.Naser Morina, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe zhvillimit Rural , Klinë

Nga : z.Luan Qerkinaj , Antarë I Komisionit , Klinë

Nga: z.Shendrit Gashi , Antarë I Komisionit , Klinë

Lënda: **Raport mbi vlersimin e tenderit "Ndërtimi I I kanaleve të ujitjes Loti I - në Dollove dhe Lot 2 – në Stup "**

Data: 15.09.2020

Lidhur me tenderin "**Ndërtimin e kanaleve të ujitjes në Dollove dhe në Stup**, ne si antarë të komisonit kemi ifilluar vlersimin po për arsye që kryetari I komisionit nuk është bashkangjitur në vlersim ne si antarë komisonit nuk kemi pas kompetenca që të marrim vendim mbi shpalljen e fitusit pa kryetarin e komisionit.

Antarë I Komisionit: Luan Qerkinaj

Antarë I Komisonit: Shendrit Gashi

Pranuar me 14.10.2020

Sa i përket pretendimeve ankimore të OE ankues "Limit Project SH.P.K & Delta-CCD SH.PK.K" në lidhje me shkeljet e dispozitave ligjore të LPP-së, gjegësisht **nenit 1** – Qëllimit, **nenit 6** – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti pasi që AK ka caktuar vet buxhetin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe nën arsyetimin se po dëmtohet një buxhet i tillë është anuluar aktiviteti përkundër faktit që oferta e OE ankues ka qenë brenda buxhetit të paparë, **nenit 7** – Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi duke i diskriminuar OE ankues të lartpërmendur përkundër që këta të fundit kanë dhënë plotësime-sqarime pas kërkesës së Autoritetit Kontraktues brenda afatit të paparë, **nenit 59** – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, **nenit 60** – Kriteret për Dhënien e Kontratës, **nenit 69** – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, **nenit 72** – Dokumentacioni dhe informatat shtesë, paragrafet 1, 2 dhe 3, dhe pretendimit ankimor të OE ankues "NNT Shkodrani – Klinë" ku thuhet që Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 1, 6, 7, 59, 60 dhe 62 – pika 1, pika 1.1 dhe pika 2.1 e këtij neni të LPP të amandamentuar pasi që anulimi i këtij AP nga ana e Autoritetit Kontraktues është i padrejtë dhe i paarsyeshëm për arsye se cmimi i ofertës së OE ankues të lartpërmendur është cmim i cili nuk tejkalon vlerën e parashikuar të për realizim të kontratës, Eksperti pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit konform kërkesave të paraqitura nga AK dhe dispozitave ligjore në fuqi, gjen pretendimet e lartpërmendura si pjesërisht të bazuara. Arsyetimi i një konstatimi të tillë vijon si më poshtë:

- Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, pasi që në Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ky i fundit anulon procedurën e prokurimit bazuar në nenin 59 të LPP-së që një rrethanë e krijuar do të rezultonte me shkelje të LPP-së. Konform dispozitës ligjore në fuqi, Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: "një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit."
- Në vendimin e Autoritetit Kontraktues, gjegjësisht arsyetimin e dhënë duke potencuar që "Komisioni bazuar në detyrat dhe obligimet e tyre bazuar në nenin 59 të LPP-së, përkundër kërkesave të Zyrës së Prokurimit dhe njoftimeve tek Zyrtari Autorizues i Njësisë Kërkuese, ZKA, me datë 14.10.2020 përmes shkresës konstaton që nuk ka mundur të përfundojë vlerësimin e tenderit. Andaj, Zyra e Prokurimit nuk mund të marrë vendim tjetër pos anulimin e procedurës duke u nisur nga Afatet për përfundim të vlerësimit", AK nuk vepron konform nenit 59 duke arsyetuar vendimin për anulim të procedurës në bazë të kronologjisë së ngjarjes, respektivisht mos arritjes së përfundimit të vlerësimit të lëndës nga komisioni vlerësues brenda afatave kohore të përcaktuara.
- Konform **nenit 40 në RRUOPP** - Krijimi i Komisioneve Vlerësuese të Tenderëve, paragrafi 7 i këtij Neni thotë që: "Komisioni do të funksionoi nga dita e miratimit të vendimit për themelim deri në përfundim të të gjitha detyrave të parashtruara nga AK, ose deri në marrje të vendimit për ndërprerje të procedurës së prokurimit. **Në rast që një ose më shumë anëtarë nuk janë në gjendje të marrin pjesë në komision, për arsye objektive dhe rrethana të tilla, ata duhet të zëvendësohen në mënyrë të njëjtë si në nominimin e tyre."** Do të thotë, mbetet nën përgjegjësinë e AK-së të zëvendësojë anëtarët e komisionit vlerësues konform dispozitës ligjore të lartpërmendur.
- Po ashtu, paragrafi 13 i nenit të lartpërmendur, thotë që **"Vendimi përfundimtar mbi dhënien e kontratës mbetet përgjegjësi e Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit**. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të pranojë rekomandimin e komisionit apo refuzojë atë. Kur refuzohet rekomandimi i komisionit, Zyrtari përgjegjës Prokurimit do të shpjegojë arsyet me shkrim. **Ne situata te tilla Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund te nxjerr vendimin përfundimtar ose mund te formoj komision te ri për ri-vlerësim."** Neni i lartpërmendur potencon rëndësinë e përgjegjësisë së Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit në marrjen e vendimit përfundimtar të vlerësimit të tenderit.

Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të të dy OE ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, Eksperti shqyrtues i sheh ankesat e operatorëve ekonomik ankues si pjesërisht të bazuara, duke sugjeruar kështu që njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "NDERTIM I KANALEVE TE UJITJES LOT 1- NE DOLLOVE, LOT 2- NE STUP", iniciuar nga AK – Kuvendi Komunal i Klinës, të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Një sugjerim i tillë vjen si rezultat i konstatimeve të pretendimeve.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues duhet të jenë: pjesërisht të bazuara dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues **KK i Klinës**
- Panelit Shqyrtues **OSHP**
- OE ankues **Limit Project SH.P.K & Delta-CCD SH.P.K**
  NNT Shkodrani